

Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

12 - pm Sh.p.k.

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është ky Statut i shoqërisë, në të cilin është përfshirë edhe Akt Themelimi i Shoqërisë.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1 Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- a. Sot, më datë 30.05.2022, unë themeluesi me të drejtën që me jep ligji dhe me besim ne Zot, themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **12 - pm SH.p.k.**
- b. Themeluesi i shoqërisë është:
ARGES KARAGJOZI, shtetas Shqiptar, I biri I Arshi, lindur në Tiranë 24.12.1978 dhe mbajtës i numrit personal H81224145K
- c. Shoqëria do të veprojë mbështetur në Ligjin Shqiptar në fuqi.
- d. Shoqëria do të regjistrohet prane organeve shtetërore si Shoqëri me Përgjegjesi të Kufizuar

Neni 2 Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Tregtimi i produkteve të ndryshëm dhe ushqimor për kafshët shtëpiake.
- Tregtimi i artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, etj.
- Tregtimi dhe shpërndarja e produkteve në adresë nëpërmjet, komunikimit online/telefonik, web, faqeve të internetit, rrjeteve sociale dhe cdo lloj forme tjetër që lejon ligji.
- Konsulencë, studime financiare dhe fiskale.
- Çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin Shqipëtar në fuqi.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4 Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Robert Shvarc, Nj. Strukturore TR/09, ZK8260, No 7/549, V52, F246, NjA5, Tirane 1022**

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale të saj në territorin e Republikës së Shqipërisë apo edhe jashtë saj në përputhje me ligjet në fuqi.

Kreu II

Kapitali, Kontributet Ndarja dhe Transferimi i kuotave

Neni 5 Kapitali themeltar

- a. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (një qind mijë) Lek. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues I vetëm, **Arges Karagjozi**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (një qind mijë) Lek. Kontributi i ortakut është i paguar plotësisht në para.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- a. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhoje kapitalin duke rritur kuotat ekzistuese me shumat që përcaktohen në varësi të vendimit të marrë prej tij.
I njëjti vendim kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet tu japi mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.
- b. Shoqëria mund të zvogelojë kapitalin me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme mbështetur në Ligjin Tregtar dhe pa e cënuar atë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b. shitblerjes,
- c. trashëgimisë,
- d. dhurimit
- e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 8 Organi Vendimmarrës i shoqërisë dhe marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë regjistrimit publik për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me 50% (pesëdhjetë) + 1 (një) vote të votave të zotëruesve të kapitalit, për vendimet e saj dhe në rastet e parashikuara ndryshe në ligj sipas kërkesës ligjore por asnjëherë me më pak se formula e sipërpërmendur.

Asambleja e Përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme por pa u kufizuar:

- a. emërimin e shkarkimin e administratorit/ëve;
- b. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- c. ndryshimet e statutit;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “a” dhe “d” të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- m. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 9 Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- a. Asambleja e përgjithshme thirret nga Administratori/rët ose secili aksioner me të drejtë vote 20% (njëzet) ose më shumë, nëpërmjet një njoftimi me shkresë dhe nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë dhe me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Njoftimi quhet I marrë në ditën e dorëzimit në adrese me postë të regjistruar. Njoftimi me postë elektronike ka vetëm efekte informuese.
- b. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës a të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Administrimi

- a. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- b. Petrin Dodona me numer personal **H310290810** dhe Arges Karagjozi me numer personal **H81224145K** caktohen si Administrator të parë i shoqërisë për një afat 5 vjeçar. Secili administrator mund të veprojë i pavarur dhe me liri të plote në të mirë të shoqërisë Brenda detyrimeve dhe të drejtave që i njeh Ligji dhe sjellja e përgjeshme ligjore.

- c. Asambleja e Përgjithshme mund ta zëvendësojë/shkarkojë administratorin apo të caktojë më shumë se 1 (një) administrator në çdo kohë. Në rast të emërimit të më shumë se 1(nje) administrator përcaktohen edhe kompetencat, kufizimet e secilit prej tyre në mënyrë individuale apo të përbashkët.

Neni 11 Kompetencat e Administratorit/ëve

Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të permbushin detyren e meposhtme dhe ne cdo rast ne perputje me perkufizimet e Ligjit:

- a. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligj;
- g. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori/ët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- a. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim.
- b. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Në rast të emërimit të më shumë se një administratori, të gjithë administratorët kanë të njëjtat detyra, të drejta dhe përgjegjësi nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga vendimi i Asamblesë së Përgjithshme.

Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e administratorit/ëve nuk mund të jenë në kundërshtim me ligjin, por ato mund të kufizohen brënda kufijve ligjore me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori/ët mund të delegojnë përmbushjen e kompetencave të tyre në përputhje me udhëzimet apo rregulloret e shoqërisë të cilat janë miratuar më parë nga Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Marrëdhënia e punësimit e Administratorit/orëve me shoqërinë rregullohet me kontratë midis palëve (shoqëria dhe administratori).

Kreu IV

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 12 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b. me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- c. me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. me vendim të gjykatës;

Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brënda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 13 Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 14 Baza Ligjore dhe Mosmarrveshjet

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Për mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ARGES KARAGJOZI

ORTAK i vetëm i SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR, “12 - pm” sh.p.k

Emër mbiemër